




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS
KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA
KLINË, 13.10.2014



**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT
I SEANCËS SË VIII-të I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA, MBAJTUR MË
13.10.2014, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KK**

Në seancë prezantuan, kryesuesi i KPF-së, dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KPF-së, përfaq. të OSBE-së etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe iu uroi mirëseardhje në këtë seancë të KPF-së. Në vijim kryesuesi prezantoi pikat e propozuara të rendit të ditës dhe propozoi që të shtohen edhe dy pika të rendit të ditës, informata lidhur me prezantimin dhe shqyrtimin në debatin me publikun të Draft-programit trevjeçar për banim dhe çështja rreth realizimit të një vizite pune të Kuvendit në Shqipëri, përkatësisht në Lezhë.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës me plotësime.

U miratua ky

REND I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave të arritura në KPF gjatë muajit shtator 2014,
4. Informatë lidhur me prezantimin dhe shqyrtimin në debatin me publikun të Draft-programit trevjeçar për banim (2013-2016),
5. Informatë rreth një vizite pune të Kuvendit të Komunës së Klinës në Shqipëri, përkatësisht në Lezhë më 27.10.2014 (e hënë).

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi që nuk ka asnjë mungesë.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit të seancës së kaluar.

Nuk pati debate.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanime u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave të arritura në KPF gjatë muajit shtator 2014.

Kryesuesi prezantoi kërkesat drejtuar KPF-së gjatë muajit shtator 2014.

Kërkesa e parë e z. Metush Mustafës nga Rudica, i cili kërkon ndihmë financiare në shumë prej 500 euro për shërim – operim të veshëve të vajzës.

Kryesuesi Ibishi, theksoi se kemi marrë qëndrim që thjeshtë kërkesa të tilla të mos i shqyrtojmë, mirëpo, meqenëse ato na vijnë, përkatësisht na adresohen, e ndiejmë për obligim për t'i shqyrtuar.

Kryesuesi hapi debatin rreth kërkesës.

Avni Gashi, theksoi se është e vërtetë që kohë më parë kemi marrë vendim që kërkesa të natyrave të tilla të mos i shqyrtojmë, mirëpo, ndërsa qytetarët kërkojnë ndihmë kemi për obligim që t'i shqyrtojmë. “Do të kishte qenë mirë që ose t'i ndalojmë kërkesa të tilla ose lidhur me to të marrim ndonjë vendim”, shtoi anëtari Gashi.

Ramush Agushi, tha se mendimi i Avniut është i mirë, mirëpo këto kërkesa kudo që adresohen ato shqyrtohen.

Fadil Gashi, tha se do të kishte qenë mirë po që se ekzistojnë mundësitë për t'i ndihmuar kësaj nxënëseje. “Ne e dimë që janë ndarë diku 60 mijë euro për entitete publike. Është subvencionuar për biznese dhe organizata të ndryshme, kanë participuar e subvencionuar edhe për ATK-në. Ne po marrim vendim që kërkesën për t'ia drejtuar Drejtorisë për Shëndetësi. Nuk kemi një rregullore për subvencione. Nuk është mirë që për 500 euro kësaj nxënëseje t'i shkojnë veshët”, theksoi anëtari Gashi.

Ndue Shabanaj, tha se edhe më herët e kemi shqyrtuar këtë çështje, thjesht jemi përcaktuar. “Prandaj, mendoj që do të kishte qenë shumë e arsyeshme që KPF-ja të mos zhvishet nga kompetencat. Është shumë e vërtetë që drejtoritë komunale i kanë kompetencat e tyre, por edhe KPF-ja ka kompetenca për të shikuar gjendjen financiare të drejtorive dhe të Komunës. Kërkesat që i takojnë këtij komiteti për to të merret vendim këtu”, pohoi prof. Shabanaj.

Halil Desku, theksoi se çështja ia vlen që të diskutohet. “Është e vërtetë shqetësuese kur na vinë kërkesa të tilla dhe ne nuk jemi në gjendje t'i zgjedhim. Mendoj që kërkesat duhet të kalojnë nëpër KPF, sepse KPF-ja nuk duhet të zhveshët nga kompetencat që i takojnë. Si Komunë e kemi shumë vështirë për të ndarë mjete, sepse ka për të pasur vërshime të kërkesave të këtyre natyrave. MSH ka fonde të tilla dhe ajo përballet me ato probleme. Si Komunë është vështirë për

të pasur fonde të tilla. DSH me stafin kanë mundësi që të merren me trajtimin e këtyre kërkesave. Trajtimet nuk bëhen vetëm në klinikat private, ato kryhen edhe në institucionet shëndetësore publike”, shtoi prof. Desku, i cili në vijim prezantoi nevojën e formimit të një komisioni që do të merrej me këtë çështje. “Ky komision i përbërë nga DSH, Drejtori i QKMF-së dhe mjekët, duhet të merren me këto çështje. Është mënyra më e mirë për t’iu dalë në ndihmë pacientëve. DSH të ngrit një ekip ekspertësh dhe ata t’i adresojnë në spitale, përkatësisht në institucionet publike. Të ndihmohen pacientët”, shtoi prof. Desku.

Haxhi Ibishi, theksoi se e njoh pacienten në fjalë dhe e di që është në gjendje të vështirë ekonomike. “DSH, apo Zyra e Kryetarit të gjejnë mundësi që të ndihmohet. Përkrah formimin e një komisioni për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të pacientëve”, shtoi dr. Ibishi, i cili në vijim foli edhe rreth aferës së fundit në shëndetësinë. “Privati është i barabartë, mirëpo ai ka rrugën tjetër”, pohoi dr. Ibishi.

Avni Gashi, tha se u potencuan disa çështje rreth temës bosht. “Kësaj radhe le të shkojë si preferencë. Të mos zhvishemi nga kompetencat tona që na takojnë”, shtoi z. Gashi.

Haxhi Ibishi, foli rreth çështjes. “Ky rast është mirë që të shikohet a mund të bëhet ndonjë zgjidhje dhe të ndihmohet”, shtoi Kryesuesi.

Halil Desku, tha se ky rast të procedohet si rastet të tjera dhe le të procedohet për t’i dalë në ndihmë. “Komisioni t’i ketë 5 anëtarë. Ne nuk i zhveshim kompetencat tona. Komisioni na sjell propozimin dhe në këtë mënyrë do të jemi më efikas”.

Fadil Gashi, foli rreth aferave të fundit në shëndetësi, përkatësisht në spitalin e zemrës në afërsi të Prishtinës. “Këto diagnoza po i përfetojmë çdo ditë. Edhe në spitale nuk ka asgjë falas, përpos shtratit dhe çarçafëve. Gjithçka duhet të blihet. Formimin e atij komisioni që u potencia e vlerësoj të panevojshëm. Kemi Drejtorinë për Shëndetësi, kemi Komitetin për Shëndetësi, prandaj mendoj që nuk kemi nevojë t’i dyfishojmë”, shtoi anëtari Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin për zgjidhje të çështjes së kësaj pacienteje.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin që kërkesa t’i drejtohet Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Zyrës së Kryetarit, që mundësisht të ndihmohet.

Propozimi u miratua me vota unanime.

Kërkesa e dytë e përfaqësuesit të lagjes në Grabanicë, z. Shkëlzen Thaqi, i cili kërkon rregullimin e rrugës së lagjes së Kodrave në Grabanicë, në gjatësi prej 550 metra, ku jetojnë 9 familje.

Avni Gashi, shtoi se kërkesa është e shkurtër, koncize dhe shumë e qartë, prandaj kisha propozuar që t’i dilet në ndihmë.

Ndue Shabanaj, tha se çdo kërkesë ka arsyen e vet, mirëpo shtrohet pyetja: “Sa nevoja të tilla kanë lokalitetet në komunën e Klinës? Mirëpo, mundësitë reale si Komunë janë të kufizuara. Pushteti lokal duhet ta ketë strategjinë, prandaj edhe duhet të punohet sipas strategjisë”.

Haxhi Ibishi, tha se Komuna ka tretman të barabartë.”Mendoj që është e rrugës që kërkesa t’i adresohet drejtorisë gjegjëse. Kërkesa t’i adresohet Drejtorisë së Urbanizmit”, pohoi kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi vuri në miratim propozimin.

Propozimi u miratua me vota unanime.

Kërkesa e tretë e Shoqatës së pensionistëve në Klinë, përfaqësuesi Prend Culaj, kryetar, kërkon mbështetje financiare për këtë organizatë në vlerë prej 3 mijë euro nga buxheti i komunës për vitin 2015.

Haxhi Ibishi, theksoi se edhe vitin e kaluar kemi pasur kërkesë të së njëjtës natyrë nga kjo shoqatë. “Kjo kërkesë t’i adresohet Kryetarit të Komunës. Nuk është në adresë ku mund t’i japim përgjigje. Vijat buxhetore janë të ndara, janë të koduara”, shtoi Kryesuesi.

Fadil Gashi, tha se shoqatave joqeveritare në qoftë se komuna fillon për t’iu ndarë buxhet do të kemi kërkesa të shumta.”Komuna nuk mund të hyjë në obligime ndaj shoqatave. Këto shoqata në forca të tyre duhet të funksionalizojnë veprimtaritë e tyre”, tha anëtari Gashi.

Pal Berisha, theksoi se këtu po shkruan: “Kjo organizatë çdoherë është financuar nga buxheti i Komunës si në të gjitha komunat tjera”.

Haxhi Ibishi, sqaroi se nuk ekziston ky konstatim që shkruan këtu. “Është shkruar gabimisht. Shoqata nuk është financuar asnjëherë, përpos që është ndihmuar. Nuk trajtohet si shoqatë qeveritare, por si shoqatë joqeveritare. Komuna është mirë për të ndihmojë po që se ka mundësi reale. Kërkesën nuk e kisha vënë as në votim sepse kemi shumë konsideratë për këtë kategori”.

Pika e katërt: Informatë lidhur me prezantimin dhe shqyrtimin në debatin me publikun të Draft-programit trevjeçar për banim (2013-2016).

Kryesuesi në mënyrë kronologjike foli rreth çështjes në rend të ditës.

U rekomandua që Draft-programi trevjeçar për banim 2013-2016 të procedohet për shqyrtim në KK.

Me vota unanime u miratua rekomandimi.

Pika e pestë: Informatë lidhur me realizimin e një vizite pune të KK në Shqipëri, përkatësisht në Lezhë, më 27.10.2014.


Haxhi Ibishi, sqaroi që edhe në kalendarin e seancave të Kuvendit të Komunës e kemi që një seancë pune të Kuvendit ta mbajmë jashtë vendit, përkatësisht në Shqipëri. “Ne jemi dakorduar që seancën e radhës, më 27.20.2014, në ora 10.00, ta mbajmë në qytetin e Lezhës. Edhe nikoqiri i Lezhës, kryetarit i Këshillit të Qarkut Lezhë, z. Augustin Marku dhe Kryetari i Bashkisë të Lezhës, z. Viktor Tushaj, kanë mirëpritur realizimin e kësaj vizite pune të Kuvendit të Komunës sonë. Ne me Bashkinë e Lezhës, edhe ashtu jemi të vëllazëruar, prandaj kjo çështje do t’i kontribuojë këtij komunikimi dhe bashkëpunimi. Seanca do të ketë karakter solemn, në mes të Bashkisë së Lezhës dhe Komunës së Klinës. Me kryetarët e Grupeve të anëtarëve menjëherë pas kësaj seance do të kontaktojmë dhe do ta bëjmë strategjinë e asaj vizite”, shtoi kryesuesi Ibishi.

Kryesuesi falënderoi të anëtarët e KPF-së për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 11.00.

Procesmbajtësi,
Mikel Gojani



Kryesuesi i KPF-së,
Dr. Haxhi Ibishi

